



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 03 korrik 2025
Nr. ref.: AGJ 2725/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO35/24

parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-248 për
Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të
Financuara nga Shteti**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Avokati i Popullit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), miratuar me Vendimin [08-V-605] e 27 korrikut 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore të shtuara në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 (Pas nenit 8, shtohet dispozita ligjore 8/A në Ligjin bazik me tekstin si në vijim:) të Ligjit të kontestuar, me pretendimin se të njëjtat nuk janë në përputhshmëri me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), si dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 shkurt 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [GJR. KO35/24], caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues, ndërsa me Vendimin [KSH. KO35/24], Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 23 shkurt 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Të njëjtën datë, Gjykata për regjistrimin e kërkesës njoftoi edhe: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit; (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit; (iv) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (v) Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme: Ministria e Financave), duke i informuar të njëjtit se në cilësinë palëve të interesuara për çështjen, mund t'i paraqesin në Gjykatë komentet e tyre, nëse kanë, lidhur me kërkesën e parashtruar, jo më vonë se 8 marsi 2024.
9. Më 27 shkurt 2024, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në Gjykatë u dorëzuan dokumentet si në vijim:

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, i proceduar në Kuvend nga Qeveria e Republikës së Kosovës, datë 10 korrik 2023;
 2. Raporti i Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 3. Kërkesa e gjashtë (6) deputetëve nënshkrues për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin në lexim të parë të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 4. Procesverbali i mbledhjes së Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 5. Vendimi i Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit nr.04/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nr. 08-V-600, datë 27 korrik 2023;
 6. Vendimi i Kuvendit për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nr.08-V-601, datë 27 korrik 2023;
 7. Procesverbali i Seancës plenare të Kuvendit, më 27 korrik 2023;
 8. Pjesë nga transkripti i Seancës plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 9. Raporti me amendamente i Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dërguar komisioneve të përhershme, lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 10. Raporti me amendamente i Komisionit funksion për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, së bashku me raportet e komisioneve të përhershme, datë 27 korrik 2023;
 11. Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, datë 27 korrik 2023;
 12. Vendimi i Kuvendit për miratimin e Ligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, nr.08-V-601, datë 27 korrik 2023;
 13. Procesverbali i Seancës plenare të Kuvendit, më 27 korrik 2023;
 14. Traskripti i Seancës Plenare, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 27 korrik 2023;
 15. Ligji nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, së bashku me shkresën dërguar Presidentes për dekretim, datë 27 korrik 2023;
 16. Dekreti nr.149/2023 i Presidentes, znj. Vjosa Osmani-Sadriu për shpalljen e Ligjit nr.08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, datë 14 gusht 2023;
 17. Shkresa drejtuar Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, për publikimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi në këtë Gazetë, datë 16 gusht 2023.
10. Më 8 mars 2024, Gjykata për kërkesën pranoi komentet nga Kryeministri.

11. Më 14 mars 2024, Gjykata për pranimin e komenteve nga ana e Kryeministrit, i njoftoi palët e interesuara si në vijim: (i) parashtruesin e kërkesës; (ii) Presidenten; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Ministrinë e Financave; dhe (v) Sekretarin e Kuvendit, duke ua ofruar mundësinë për paraqitjen e komenteve shtesë, jo më vonë se 28 marsi 2024.
12. Më 22 mars 2024, Gjykata pranoi komente nga Ministria e Financave.
13. Më 27 mars 2024, Gjykata pranoi komente nga Sindikata e Pensionistëve të Kosovës.
14. Më 24 shtator 2024, Gjykata vendosi për shtyrjen e vendimmarrjes për plotësime shtesë të raportit.
15. Më 2 nëntor 2024, Gjykata në qëllim të finalizimit të shqyrtimit të kërkesës KO35/24, kërkoi nga Ministria e Financave, të qartësonte çështjet përkitazi me: 1...*“a) lartësinë e pensionit mujor që ka ekzistuar sipas nenit 8 [Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës] të Ligjit bazik, me rastin e hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar për pensionistët nga “skema kontributpaguese e moshës”, të ndarë sipas kategorive; dhe (b) lartësinë e pensionit mujor që përfitojnë pensionistët nga “skema parciale kontributpaguese e moshës”, si pasojë e nxjerrjes së Ligjit të kontestuar, të ndarë sipas kategorive, përfshirë nivelin e përcaktuar sipas paragrafit 4 të nenit 8/A (Pensioni parcial kontributpagues i moshës) të Ligjit të kontestuar, dhe (2) Ligji i kontestuar ka eliminuar paragrafin 6 të nenit 8 [Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës] të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara në Shteti, nën ky i cili ndërlidhet me të drejtat e “punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerave që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës përgjatë viteve 1989-1999”. Në këtë kontekst: Ju lutem sqaroni si afektohet kjo kategori qytetarësh në kontekst të skemës së re pensionale, përkatësisht “skemës parciale kontributpaguese të moshës” ndërlidhur me reduktimin potencial të lartësisë së pensionit sipas dispozitave të nenit 8 [Kompensimi tranzitor i reduktimit të lartësisë së pensionit] të Ligjit të kontestuar.”*
16. Më 12 nëntor 2024, Ministria e Financave dorëzoi përgjigjet në pyetjet e Gjykatës, të cilat janë reflektuar në pjesën e komenteve dhe përgjigjeve.
17. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.
18. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërzhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 5 mars 2025, Gjykata vendosi shtyrjen e vendimmarrjen për rastin, për një seancë tjetër të radhës.
20. Më 20 maj 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata njëzëri vendosi që neni 4 i Ligjit Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, që shton nenin 8A, pas nenit 8 në Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk është në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 5 korrik 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) nëpërmjet Vendimit [Nr. 02/149], miratoi Ligjin e kontestuar.
22. Më 7 korrik 2023, Qeveria e procedoi Ligjin e kontestuar në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim, sipas procedurës së përcaktuar.
23. Më 27 korrik 2023, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Funksional), rekomandoi që Ligji i kontestuar të miratohet në parim.
24. Më 27 korrik 2023, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejshëm: LVV), në emër të deputetëve nënshkrues, bazuar në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, paraqiti në Kuvend kërkesë për shmangie nga afatet e rregullta procedurale të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtim të Ligjit të kontestuar.
25. Në të njëjtën ditë, (i) Kuvendi nëpërmjet Vendimit [Nr. 08-V-600] e miratoi në parim Ligjin e kontestuar; (ii) Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Buxhet), rekomandoi që Ligji i kontestuar përmban implikime shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës; (iii) Komisioni për Integritet Evropian konstatoi që Ligji i kontestuar nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian; (iv) Komisioni funksional miratoi dy amendamente të propozuara në lidhje me Ligjin e kontestuar, ndërsa refuzoi tre amendamente të tjera të propozuara nga deputeti i Kuvendit Shemsedin Dreshaj; dhe (v) Komisioni funksional e procedoi Ligjin e kontestuar në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.
26. Në të njëjtën ditë, përkatësisht më 27 korrik 2023, Kuvendi nëpërmjet Vendimit [Nr. 08-V-605] e miratoi Ligjin e kontestuar me votat “për” të gjashtëdhjetë e dy (62) deputetëve.
27. Më 7 gusht 2023, Kryetari i Kuvendit ia përcolli Ligjin e kontestuar Presidentes për dekretim dhe shpallje.
28. Më 14 gusht 2023, Presidentja nëpërmjet Dekretit [149/2023] e shpalli Ligjin e kontestuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se dispozitat e shtuara nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht të nenit 8/A, janë në kundërshtim me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), si dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit

nr. 12 të KEDNJ-së. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se nënparagrafi 2.4 i nenit 8/A i Ligjit të kontestuar, i cili përcakton se: *“2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.”*, është i papajtueshëm me nenet e lartcekura. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon që Ligji i kontestuar nuk ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit KO190/19, në kuptim të barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit.

30. Parashtruesi i kërkesës ngre në Gjykatë tre çështje kryesore. Çështja e parë ka të bëjë me faktin: (i) nëse Ligji i kontestuar ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës të shprehura nëpërmjet Aktgjykimit KO190/19, në kuptim të a) barazisë para ligjit; b) ndalimit të diskriminimit, sipas nenit 14 të KEDNJ-së, dhe b) ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, sipas nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Çështja e dytë ka të bëjë me faktin se: (ii) qëllimi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO190/19, ka qenë largimi i kufizimit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar për stazhin kontributpagues për qytetarët, të cilët për shkak të largimit nga puna si pasojë e masave të dhunshme nuk kishin mundur të arrinin stazhin e kërkuar. Ndërsa çështja e tretë ka të bëjë me pretendimin se: (iii) neni 4 i Ligjit të kontestuar përdor emërtimin “Pension parcial kontributpagues i moshës”, dhe kjo përbën një skemë të re e cila nuk parashihet me nenin 4 të Ligjit bazik dhe se Ligji i kontestuar nuk e ndryshon nenin 4 të Ligjit bazik, si dhe nuk e përcakton definicionin e këtij emërtimi, gjë që e bën edhe më të paqartë Ligjin e kontestuar.

(i) Në lidhje me çështjen e parë, nëse Aktgjykimi i Gjykatës, në rastin KO190/19, ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës në kuptim të barazisë para ligjit dhe të ndalimit të diskriminimit

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar nuk ka marrë parasysh gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19, në kuptim të barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës rikujton faktin që Gjykata nëpërmjet Aktgjykimit të cekur kishte konstatuar se paragrafi 2 i nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit bazik në lidhje me nënparagrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues, sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së pagesës së Kontributeve (në testin e mëtejme: Udhëzimi administrativ), duhet të shfuqizohen si kundërkushtetuese, duke e detyruar Qeverinë dhe Kuvendin të ndërmerrnin veprimet e nevojshme për plotësimin e Ligjit bazik në përputhje me gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës, deri më 15 korrik 2023.

(ii) Në lidhje me çështjen e dytë, “se qëllimi i Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19, ka qenë largimi i kufizimit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar për stazhin kontributpagues”

32. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se qëllimi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO190/19, ka qenë largimi i kufizimit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar për stazhin kontributpagues, për qytetarët të cilët për shkak të largimit nga puna si pasojë e masave të dhunshme nuk kishin mundur të arrinin stazhin e kërkuar para 1 janarit 1999. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO190/19 dhe Raporti [nr. 235/2018] me rekomandime i Institucionit të Avokatit të Popullit, i 6 prillit 2018, kishin konstatuar se kufizimi pesëmbëdhjetë (15) vjeçar është në kundërshtim me garancitë kushtetuese për barazinë para ligjit.

33. Parashtruesi i kërkesës, thekson ndër të tjera që (i) Ligji i kontestuar e ruan kufizimin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, duke mos marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO190/19, sepse në nënparagrafin 2.4 të nenit 8/A, përcakton që: *“shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999, bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh”* dhe, në njërën anë, njeh stazhin kontributpagues për periudhën 1989-1999, por nga ana tjetër kërkon përmbushjen e kriterit prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh për ta përfituar pensionin parcial kontributpagues të moshës; (ii) se ruajtja e këtij kriteri pesëmbëdhjetë (15) vjeçar ua mohon pensionistëve të drejtën e realizimit të pensionit kontributpagues të moshës, të cilët nuk e arrijnë kriterin e përcaktuar, duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë para ligjit dhe që një kufizim i tillë, ndikon jo vetëm në pensionin kontributpagues të moshës, por edhe në skemat e tjera, si pensionet familjare që trashëgohen nga familjarët e të punësuarit, i cili po ashtu duhet t'i ketë pasur pesëmbëdhjetë (15) vjet stazh kontributpagues, në mënyrë që familjarët e tij/saj të përfitojnë nga kjo skemë pensionale; dhe (iii) se një rregullim i tillë, cenon dinjitetin e njeriut të mbrojtur me nenin 23 [Dinjitetit i Njeriut] të Kushtetutës, sepse të gjithë pensionistët të cilët kanë arritur të kontribuojnë në fondin pensional për pesëmbëdhjetë (15) vite, shteti i Kosovës ka marrë përsipër t'i kualifikojë si pensionistë kontributpagues, ndërsa, të tjerët, të cilët pa vullnetin e tyre nuk kanë arritur stazhin kontributpagues prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, në fondin që mbahet nga Republika e Serbisë, nuk kualifikohen si pensionistë kontributpagues nga shteti i Republikës së Kosovës.

(iii) Në lidhje me çështjen e tretë se, “neni 4 i Ligjit të kontestuar përdor emërtimin “Pension parcial kontributpagues i moshës”, dhe kjo përbën një skemë të re e cila nuk parashihet me nenin 4 të Ligjit bazik”

34. Në lidhje me këtë pohim, parashtruesi i kërkesës thekson se neni 4 i Ligjit të kontestuar përdor emërtimin *“Pension parcial kontributpagues i moshës”*, dhe kjo përbën një skemë të re e cila nuk parashihet me nenin 4 të Ligjit bazik, sepse Ligji i kontestuar nuk e ndryshon nenin 4 të Ligjit bazik dhe nuk e përcakton definicionin e këtij emërtimi, gjë që e bën edhe më të paqartë Ligjin e kontestuar.

Zgjidhja e kërkuar

35. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës konsideron se kufizimi i përcaktuar në nenin 4 të Ligjit të kontestuar përbën shkelje kushtetuese, sepse nuk e eviton dallimin në trajtim mes dy grupeve të qytetarëve të cilët janë në pozita të ngjashme përkitazi me fushëveprimin e kategorisë së pensioneve kontributpaguese, dhe se ky dallim në trajtim vazhdon të jetë i përcaktuar me ligj. I njëjti, gjithashtu thekson që ka pranuar 2 (dy) ankesa në lidhje me Ligjin e kontestuar, përkatësisht (i) ankesa e parë e pranuar, më 5 shkurt 2024 nga Rrahman Jashari, kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, i cili ka kërkuar pezullimin e zbatimit të ndryshimit dhe plotësimit, si dhe anulimin e Vendimit nr. 51, të 19 tetorit 2023 të Ministrisë së Financave, për shkak të diskriminimit; dhe (ii) ankesa e dytë e pranuar, më 8 shkurt 2024, nga Shemsedin Dreshaj, deputet i Kuvendit, sipas të cilit Ligji i kontestuar diskriminon një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të vendit, të cilët kanë vepruar dhe kontribuar në Kosovë, dhe si i tillë nuk vlen për shtetet që kanë dalë nga konfliktet e armatosura. Sipas parashtruesit të kërkesës, zgjidhja e duhur do të ishte shkallëzimi sipas viteve të kontributeve, ngjashëm sikurse është bërë për mësimdhënësit për vitet e 90-ta, duke marrë parasysh avancimet, titujt shkencorë dhe profesionalë me rastin e pensionimit.

Komentet e Kryeministrit

36. Kryeministri në komentet e tij, dorëzuar Gjykatës më 8 mars 2024, rikujton që Gjykata në rastin KO190/19, kishte vlerësuar nëse ekziston diskriminimi për qytetarët që obligoheshin të dëshmonin stazhin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh pension, si punëtorët e zanatit, punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore e të ngjashëm që dështonin të ofronin dëshmi përkatëse, sepse ishin larguar nga puna në vitet e 90-ta, bazuar në ligje diskriminuese, kategori kjo të cilave komentet përkatëse i referohen si grupi i parë, në raport me punëtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kishin punuar në sistemin paralel të Kosovës, të cilëve iu njëhej stazhi pensional në vitet 1989-1999 me ligj, kategori kjo të cilave komentet përkatëse i referohen si grupi i dytë. Në këtë kontekst, Kryeministri thekson se Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se ekzistonte dallimi në trajtim ndërmjet grupit të parë dhe të dytë, sepse dallimi ishte i përcaktuar me ligj dhe kishte një qëllim legjitim, mbrojtjen e sistemit ekonomik të vendit. Megjithatë, Gjykata kishte konstatuar se dallimi në trajtim nuk ishte proporcional, sepse nuk kishte marrë parasysh aplikimin e ligjeve diskriminuese përgjatë viteve të 90-ta, si pasojë e të cilave ishin larguar nga puna punëtorët e etnisë shqiptare, përmes masave të dhunshme, prandaj këtij grupit të parë iu pamundësua pagimi i kontributeve pensionale me qëllim të njohjes së stazhit pensional.
37. Kryeministri më tej thekson se Kuvendi e ka miratuar Ligjin e kontestuar, i cili e ndryshon dhe plotëson Ligjin bazik nëpërmjet shfuqizimit të dispozitave ligjore të cilat janë konstatuar si kundërkushtetuese dhe integron grupin e parë në sistemin pensional shtetëror nëpërmjet krijimit të një skeme të re pensionale, të titulluar *“Pensioni Parcial Kontributpagues i Moshës”*. Sipas Kryeministrit, Ligji i kontestuar i adreson të gjeturat e Gjykatës për faktin se grupi i parë i personave, të cilët nuk mund të dëshmonin stazhin pensional për shkak të largimit nga puna, si rezultat i ligjeve diskriminuese të asaj kohe, të njëjtit tanimë kualifikohen në *“Pensionin Parcial Kontributpagues të Moshës”*. Sipas komenteve, (i) kushti kryesor për realizmin e këtij pensioni është që personi i grupit të parë, në formë kumulative duhet ta arrijë periudhën kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, sipas Ligjit të ish-RSFJ-së; dhe (ii) periudha e mbetur e cila nuk mund të mbulohet me dëshmi formale të stazhit të paguar, sipas Ligjit të ish-RSFJ-së, duhet të mbulohet me periudhën e largimit nga puna nëpërmjet ligjeve diskriminuese ose masave të dhunshme, që marrë së bashku arrijnë periudhën kushtëzuese prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.
38. Tutje, Kryeministri thekson se personat që i takonin grupit të dytë, e që nuk arrinin të dëshmonin stazhin pensional, përmes kontributit, për t’u kualifikuar për pensionin e “plotë” kontributpagues të moshës, tanimë të njëjtit trajtohen në kuadër të kriterëve të pensionit *“parcial”* kontributpagues të moshës. Sipas komenteve, në këtë skemë të re, *“integrohen personat nga grupi i parë dhe rikualifikohen personat nga grupi i dytë, duke i mënjeluar dallimet në trajtim ndërmjet grupeve”*, duke theksuar se lartësia e pensionit do të paguhet në formë parciale, varësisht nga numri i viteve të kontributeve të paguara sipas Ligjit të ish-RSFJ-së.
39. Në kontekst të komenteve të dorëzuara nga Avokati i Popullit, përkatësisht (i) pretendimin e tij që Gjykata ka urdhëruar largimin e periudhës kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, Kryeministri thekson se një pretendim i tillë nuk është i saktë, sepse Gjykata vetëm kishte konstatuar se dallimi në trajtim i grupeve nuk ka qenë proporcional, ndërsa mënyra e adresimit të proporcionalitetit i është lënë në dorë pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, duke ia njohur hapësirën e vlerësimit në përcaktimin e politikave publike; ndërsa (ii) pretendimin që personat që nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, si rezultat i largimit nga puna nëpërmjet ligjeve diskriminuese ose nëpërmjet masave të dhunshme, nuk përfitojnë nga pensioni shtetëror i paguar nga buxheti i Kosovës, Kryeministri thekson se një konstatim i tillë

nuk është i saktë, sepse Ligji i kontestuar në nenin 8/A, i kualifikon personat të cilët janë larguar nga puna gjatë viteve të 90-ta, si rezultat i ligjeve diskriminuese ose i masave të dhunshme, në skemën e “*pensionit parcial kontributpagues të moshës*”, mirëpo, për këta persona, kushti i ri i vendosur në pajtim me parimin e proporcionalitetit dhe qëllimit legjitim, është të dëshmojnë periudhën kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare në formë kumulative.

40. Në mbështetje të komenteve të tij, Kryeministri i referohet rastit të GJEDNJ-së, *Kudumija kundër Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë, nr.28233/08, 56190/08, 239/11*, duke theksuar se në këtë rast, parashtruesit e kërkesës ishin kontribues në fondin ushtarak të pensioneve, që ishte organizuar në nivel federativ të ish-RSFJ-së. Pas shpërthimit të luftës në Bosnje, Serbia ndërpreu pagesën e pensionit ushtarak për parashtruesit e kërkesës. Nga viti 1992, parashtruesit e kërkesës filluan të përfitojnë pesëdhjetë përqind (50%) të lartësisë së pensionit ushtarak nga buxheti i shtetit të Bosnjës, ndonëse kontributi pensional ishte paguar në nivel federativ, dhe jo atë republikan. Parashtruesit e kërkesës iu drejtuan GJEDNJ-së, për të vlerësuar nëse pagesa prej pesëdhjetë përqind (50%) e kontributeve të tyre ua kishte cenuar atyre të drejtën e pronës. GJEDNJ-ja kishte konstatuar se pagesa prej pesëdhjetë përqind (50%) ka qenë një metodë e integritit në sistemin pensional. GJEDNJ-ja theksoi se shtetet kanë në dispozicion të tyre një hapësirë të gjerë të vlerësimit në përcaktimin e politikave publike. Sipas Kryeministrit, fakti që një shtet vendos të ofrojë kushte më të favorshme për personat që kanë kontribuar në pensionin republikan, krahas atyre që kanë kontribuar në sistemin federativ, sipas GJEDNJ-së, bie nën hapësirën e gjerë të vlerësimit.
41. Në këtë kontekst, Kryeministri thekson se Qeveria gëzon hapësirë të gjerë të vlerësimit në metodën sesi i integron personat e grupit të parë në sistemin pensional të financuar nga buxheti shtetëror. Këtë hapësirë të vlerësimit, pushteti ekzekutiv dhe legjislativ e ka ushtruar nëpërmjet krijimit të skemës për kontributin parcial kontributpagues në sistemin pensional. Sipas Kryeministrit, fakti që personat të cilët arrijnë të dëshmojnë pagesën e kontributit pensional në periudhën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, gëzojnë kushte më të favorshme, duhet të konsiderohet vetëm si një ushtrim i së drejtës në përcaktimin dhe rregullimin e politikave sociale, përkitazi me qëllimin legjitim, siç është konstatuar edhe nga Gjykata. Personat të cilët nuk mund të ofrojnë dëshmi sipas Ligjit të ish-RSFJ-së, pra që nuk kualifikohen as në sistemin parcial kontributpagues të moshës, e as në sistemin e plotë kontributpagues të moshës, do të vazhdojnë sërish të financohen nga pensioni shtetëror nga kategoria e pensionit bazik të moshës.
42. Në fund, Kryeministri thekson që Gjykata duhet të shpallë të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, sepse Ligji i kontestuar: (i) integron në sistemin pensional parcial kontributpagues të moshës të gjithë personat që nuk e kanë arritur periudhën kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare të stazhit pensional, si rezultat i largimit të dhunshëm nga puna dhe ligjeve diskriminuese; (ii) evitohen dallimet në trajtim ndërmjet grupit të parë dhe grupit të dytë, sepse tanimë të gjithë personat vlerësohen sipas kriterëve të barabarta për përfitim të pensionit; (iii) personat që edhe po të mos ishin larguar dhunshëm nga puna gjatë viteve të 90-ta nuk do të arrinin stazhin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, sërish financohen nga pensioni shtetëror nëpërmjet pensionit bazik të moshës; dhe (iv) kjo zgjedhje e nivelizimit dhe integritit të personave në sistemin pensional shtetëror duhet të konsiderohet si autoritet që bie nën hapësirën e gjerë të vlerësimit të politikbërjes dhe nuk ngërthen çështje kushtetuese.

Komentet e Ministrisë së Financave

43. Ministria e Financave, më 22 mars 2024, dorëzoi komente në Gjykatë, duke shprehur pajtimin e saj me komentet e dorëzuara nga Kryeministri. Në komentet e saj, ndër të

tjera, Ministria gjithashtu thekson: *“Ligji i kontestuar i integron në sistemin pensional parcial kontributpagues të gjithë personat që nuk e kanë arritur periudhën kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare të stazhit pensional si rezultat i largimit të dhunshëm nga puna dhe si rezultat i ligjeve diskriminuese, janë evituar dallimet në trajtim ndërmjet grupi të parë dhe grupit të dytë, ku tanimë të gjithë vlerësohen sipas kritereve të barabarta për përfitimin e pensionit, personat që edhe po të mos ishin larguar dhunshëm nga puna gjatë viteve 90-ta, sërish nuk do të arrinin stazhin prej pesëmbëdhjetë (15) viteve sërish financohen nga pensioni shtetëror përmes pensionit bazik të moshës”.*

Komentet e dorëzuara (sipas dokumentit) nga bashkimi i sindikatave të pavarura të Kosovës (BSPK)

44. Më 27 mars 2024, Gjykata ka pranuar vëllim të dokumenteve nga BSPK në lidhje me Ligjin e kontestuar. Megjithatë, përveç disa dokumenteve të bashkëngjitura, shkresa e tyre nuk përmban komente dhe/ose argumente në lidhje me Ligjin e kontestuar.

Përgjigjja e Ministrisë së Financave në kërkesën e Gjykatës

45. Më 13 nëntor 2024, Gjykata ka pranuar përgjigjet nga Ministria e Financave, përkitazi me pyetjet e Gjykatës, të cilat ndërlidheshin me ndryshimet e bëra përmes nenit 4 të Ligjit të kontestuar, në Ligjin bazik. Në këtë kontekst, përkitazi me pyetjen e parë, Ministria e Financave thekson se a) me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, lartësia e pensionit kontributpagues të moshës ka qenë, si në vijim: për nivelin e parë (I) 182,00 euro, të dytin (II) 198 euro, të tretin (III) 214 euro, dhe të katërtin (IV) 265 euro. Ndërsa, b) lartësia e pensionit sipas skemës së re (parciale), si pasojë e nxjerrjes së Ligjit të kontestuar është si në vijim: niveli i parë (I) 175.04 euro, i dyti (II) 191.42 euro, i treti (III) 206,40 euro, dhe i katërti (IV) 254.00 euro.
46. Sipas shpjegimit të Ministrisë së Financave, përcaktimi i lartësisë së pensionit, për skemën e plotë dhe parciale merr për bazë: (i) shumën e pensionit bazik të moshës, (ii) vitet e kontributeve, dhe (iii) koeficientin vjetor (1/15) të diferencës mes a) lartësisë së pensionit kontributpagues, sipas nivelit të shkollimit, dhe b) lartësisë së pensionit bazik të moshës.
47. Për sa i përket pyetjes së dytë, nëse ndryshimet e bëra përmes Ligjit të kontestuar, kanë afektuar lartësinë e pensionit të punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave thekson se është e rëndësishme të bëhet dallimi mes: *“1. Periudhës së sigurimit pensional (stazhit kontributdhënës të punës) dhe 2. Periudhës së pagesës së kontributeve”.* Kjo për faktin se periudha e sigurimit pensional, sipas ministrisë në fjalë, nënkupton kushtin kualifikues të paraparë me Ligjin nr. 011-24/83 të KSAK-së, një model ky i përhapur në vendet që përdorin sistemin e sigurimit pensional *“pay-as-you-go”*, që aplikohet në vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe të Bashkimit Evropian, si Austria, Portugalia, Kroacia, të cilat po ashtu aplikojnë kushtin kualifikues pesëmbëdhjetë (15) vjeçar. Në vazhdim, Ministria e Financave thekon se për shkak të rrethanave të veçanta të largimit masiv nga puna gjatë viteve të 90-ta, në kontekstin e Republikës së Kosovës, periudha e kualifikimit përfshin periudhën e përvojës së punës para vitit 1989 dhe periudhën e përvojës së punës nga viti 1989 deri në vitin 1999, të cilat, të marra së bashku, llogariten sipas mënyrës së përcaktuar përmes nënparagrafi 2.4 të nenit 8A të Ligjit të kontestuar.
48. Si përfundim, Ministria e Financave, thekson, *“...Neni 8 ka paraparë periudhë kompensimi transitor për përfituesit e Pensionit Kontributpagues të cilët kalojnë nga skema ekzistuese në skemën e re të Pensionit Parcial Kontributpagues. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Kontestuar, të gjitha kërkesat që MFPT ka pranuar dhe trajtuar kanë*

qene nga personat përfitues te skemës se Pensionit Bazik te Moshës, qe kane aplikuar për te kaluar ne skemën e Pensionit Parcial Kontributpagues, por nuk ka pasur asnjë kërkesë nga ndonjë përfitues qe te kaloje nga skema e Pensionit Kontributpagues ne skemën e Pensionit Parcial Kontributpagues. Rrjedhimisht, nuk ka lindur nevoja për te zbatuar Nenin 8 ne asnjë rast deri me tani.”

DISPOZITAT RELEVANTE KUSHTETUESE DHE LIGJORE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 23

[Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 55

[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*
- 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.*

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme
[...]

Neni 93
[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
 - (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
 - (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- [...]

Neni 94
[Kompetencat e Kryeministrit]

[...]

(3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 14
(Ndalimi i diskriminimit)

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

**Protokolli Nr.12 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
dhe të Lirive Themelore**

Neni 1
(Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit)

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

**LIGJI NR. 04/L-131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA
SHTETI**

(Ligji bazik)

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj rregullon dhe përcakton:

- 1.1. pensionet bazike të moshës, pensionet kontributpaguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti;
- 1.2. konsolidimin, harmonizimin dhe unifikimin e skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës;
- 1.3. krijimin e një kornize ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të këtyre pensioneve për shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe për shtetasit e huaj, në përputhje me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës me shtetet përkatëse;

1.4. kriteret dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension për pagesat e pensioneve.

Neni 8

Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse. (shfuqizuar me Aktgjykimin KO190/19 dhe i fshirë me Ligjin e kontestuar)

3. Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj.

4. Përgjashtëmësi, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.

5. Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale.

6. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës. (Paragraf i fshirë nëpërmjet Ligjit të kontestuar)

Neni 13

Lartësia e shumës së pensioneve

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

LIGJI NR.08/L-248 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI

(Ligji i kontestuar)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

Neni 2

Plotësohet neni 3 i Ligjit Bazik, ashtu që pas nën-paragrafit 1.13 të paragrafit 1, shtohet nën-paragrafi 1.14 me tekstin si në vijim:

1.14. Rezident – nënkupton praninë fizike në Republikën e Kosovës mbi njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë në çdo periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujore

Neni 3

Fshihet paragrafi 2 dhe paragrafi 6 i nenit 8 të Ligjit Bazik.

Neni 4

Pas nenit 8, shtohet dispozita ligjore 8/A në Ligjin Bazik me tekstin si në vijim:

Neni 8/A

[Pensioni parcial kontributpagues i moshës]

1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen.
2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim:
 - 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;
 - 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;
 - 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme;
 - 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.
3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri.
4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.

Neni 8

Kompensimi tranzitor i reduktimit të lartësisë së pensionit

1. Në rastet kur pensionistët kalojnë nga skema e pensionit kontributpagues të moshës në skemën parciale të pensionit kontributpagues të moshës si rezultat i hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe pësojnë reduktim të lartësisë së pensionit, kompensohen në format tranzitor si në vijim:
 - 1.1. Deri më 31.12.2023, pensionisti kompensohet me njëqind për qind (100%) të diferencës ndërmjet pensionit të fundit të realizuar me Ligjin Bazik, dhe realizimit të pensionit sipas kriterëve me këtë ligj;
 - 1.2. Deri më 31.12.2024, pensionisti kompensohet me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të diferencës ndërmjet pensionit të fundit të realizuar me Ligjin Bazik, dhe realizimit të pensionit sipas kriterëve me këtë ligj;
 - 1.3. Deri më 31.12.2025, pensionisti kompensohet me pesëdhjetë për qind (50%) të diferencës ndërmjet pensionit të fundit të realizuar me Ligjin Bazik, dhe realizimit të pensionit sipas kriterëve të këtij ligji.
2. Ky kompensim tranzitor nuk aplikohet për personat që fillojnë marrjen e pensionit pas datës 15.07.2023.

(Teksti i konsoliduar, aktualisht në fuqi)

Neni 8

Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:
 - 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;
 - 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;
 - 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.
3. Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj.
4. Përfshirë, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale.
5. Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale.

Neni 8/A

Pensioni parcial kontributpagues i moshës

1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen.
2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim:
 - 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;
 - 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;
 - 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989, si rezultat i masave të dhunshme;
 - 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.
3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri.
4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.

Udhëzimi Administrativ [Nr.09/2015] për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues, sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së Kontributeve—Stazhit Pensional

Neni 5

Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues

1. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të ultë, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontributpagues, pa ose me përgatitje shkollore të ultë.
2. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme.
3. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e lartë.
4. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare.
5. Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991.

Neni 6

Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues, përkatësisht të sigurvearit me rastin e parashtrimit të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë.
2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme, si:
 - 2.1 Letërnjoftimin e Republikës së Kosovës;
 - 2.2 Ekstraktin e Lindjes;
 - 2.3 Të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, nr.26/83, i cili vërtetohet me ndonjë nga këto dokumente, si: (shfuqizuar me Aktgjykimin KO190/19)
 - 2.3.1 vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontributpagues sipas dispozitave të Ligjit të SPI-së Nr. 26/83, para datës 01.01.1999;
 - 2.3.2 çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave të Ligjit të SPI-së të Kosovës;
 - 2.3.3 librezën e punës me numrin amëz të sigurvearit;
 - 2.3.4 dëshminë se i ka paguar kontributet vet ose punëdhënësi ku ka punuar;
 - 2.3.5 ekstraktin nga M-4, nëse i posedojnë zyrrat pensionale, të cilat nxirren, verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës;
 - 2.3.6 dëshmi se nuk është përfitues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për të cilat Kosova nuk ka marrëveshje; (shfuqizuar me Aktgjykimin KO190/19)

LIGJI NR. 06/L-073 PËR STATUSIN E PUNËTORËVE TË ARSIMIT SHQIP TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA VITI SHKOLLOR 1990/91 DERI NË VITIN SHKOLLOR 1998/99

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Ligji është njohja e përvojës së punës dhe përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë mbi pensionin që realizon të përfituesit, për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Neni 2 Fushëveprimi

- 1. Fushëveprimi i këtij Ligji është përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.*
- 2. Ky ligj nuk zbatohet ndaj të gjithë punonjësve që kanë kontribuar gjatë kësaj periudhe dhe janë financuar jashtë sistemit të Republikës së Kosovës.*

Ligji për të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor (Shpallur në “Gazetën Zyrtare të RSFJ-së”, nr. 23/82, 77/82, 75/85, 8/87, 65/87, 87/89, 44/90, 41/94)

Neni 21 Pensioni i pleqërisë

Punonjësi nga neni 18 deri 20 të këtij Ligji (në tekstin e mëtejme: i siguruari) fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 60 vjet (mashkull), respektivisht 55 vjet (femër) të jetës dhe 20 vjet të stazhit të pensionit.

I siguruari i cili nuk ka arritur stazhin e pensionit prej 20 vitesh e fiton të drejtën në pensionin e pleqërisë kur mbush 65 vjet (mashkull), respektivisht 60 vjet (femër) të jetës dhe së paku 15 vjet të stazhit të sigurimit.

I siguruari e fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 40 vjet (mashkull), respektivisht 35 vjet të stazhit të pensionit (femër), pavarësisht nga vitet e jetës.

Pranueshmëria e kërkesës

- 49. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.*
- 50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës, që përcaktojnë të drejtën e Avokatit të Popullit për t’u paraqitur si parashtrues para Gjykatës:*

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

[...]

- 2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.

[...]

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit]

[...]

- 4. Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.*

Neni 29
(Saktësimi i kërkesës)

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrihen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.
2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Neni 30
(Afatet)

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrihet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

Rregulli 65

[Kërkesa në pajtim me nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit]

- “(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nënparagrafët (1) dhe (2) të paragrafit (2) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit.*
- (2) Kur parashtron një kërkesë në pajtim me paragrafin (2) të nenit 113 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, ndër të tjera, nëse përmbajtja e plotë ose pjesë të caktuara të aktit të kontestuar, konsideron të jenë në mospërputhshmëri me Kushtetutën.*
- (3) Pala e autorizuar duhet të paraqesë në kërkesë kundërshtimet lidhur me kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar.*
- (4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrihet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.”*

51. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e aktit të kontestuar; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet nëpërmjet paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe nënregullit (2) dhe (3) të rregullit 65 të Rregullores së punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar, ashtu siç përcaktohet në nenin 30 të Ligjit dhe nënregullin (4) të rregullit 65 të Rregullores së punës.

(i) Lidhur me palën e autorizuar dhe aktin e kontestuar

52. Bazuar në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është i autorizuar të ngrejë në Gjykatë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të: (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit; (iii) dhe të rregulloreve të Qeverisë. Kjo e drejtë përcaktohet edhe me nenin 29 të Ligjit dhe rregullin 65 të Rregullores së punës. Në rastin konkret, Avokati i Popullit në cilësinë e parashtruesit të kërkesës konteston në Gjykatë përputhshmërinë e Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të miratuar në Kuvend. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Avokati i Popullit është palë

e autorizuar sipas Kushtetutës dhe konteston një akt juridik, përkatësisht Ligjin e kontestuar Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

(ii) Lidhur me saktësimin e kërkesës

53. Bazuar në nenin 29 të Ligjit dhe rregullin 65 të Rregullores së punës, kërkesa e ngritur sipas nënparagrafit (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet të specifikojë para së gjithash: (i) nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të tij, konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë pretendimet apo kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit juridik të kontestuar. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozita të caktuara të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht në mënyrë specifike konteston nënparagrafin 2.4 të nenit 8A të Ligjit të kontestuar, për të cilin pretendon se është në kundërshtim me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në Gjykatë konteston pjesë të veçanta të Ligjit të kontestuar dhe ka specifikuar kundërshtimet e ngritura rreth kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar.

(iii) Lidhur me afatin

54. Bazuar në nenin 30 të Ligjit dhe rregullin 65 (4) të Rregullores së punës, kërkesa e referuar sipas nënparagrafit (1) të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës duhet parashtruar brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar u miratua në Kuvend më 7 gusht 2023, ndërsa hyri në fuqi më 28 gusht 2023. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar më 14 shkurt 2024, përkatësisht brenda afatit ashtu siç përcaktohet me dispozitat e lartcekurat.

(iv) Konstatimi përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës

55. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar para Gjykatës; (ii) konteston një ligj të Kuvendit; (iii) ka specifikuar se konteston pjesë të veçanta të Ligjit të kontestuar dhe ka saktësuar kundërshtimet kushtetuese; dhe (iv) ka parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall të pranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe do të vijojë me shqyrtimin e meritave të kërkesës.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

56. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës, respektivisht Avokati i Popullit, kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, përkatësisht pretendon që neni 4 i tij, përmes të cilit pas nenit 8, shtohet neni 8/A në Ligjin Bazik është në kundërshtim me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, si dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
57. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO190/19, në thelb, pretendon se Gjykata Kushtetuese përmes këtij Aktgjykimi ka urdhëruar largimin e kushtëzimit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, të stazhit pensional, për qytetarët të cilët për shkak të largimit nga puna, si pasojë e ligjeve diskriminuese ose aplikimit të masave të dhunshme, nuk arrinin të përmbushnin kushtin pesëmbëdhjetë

(15) vjeçar të stazhit pensional, për t'u kualifikuar në “*skemën e pensionit kontributpagues të moshës*”. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkesës më saktësisht pretendon se nënparagrafi 2.4 i nenit 8/A i cili është shtuar në Ligjin bazik pas nenit 8, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me qëllimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KO190/19, respektivisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (të Gjykatës Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Përveç tjerash, parashtruesi i kërkesës thekson se Ligji i kontestuar në përmbajtjen e tij përdor emërtimin “*Pension parcial kontributpagues i moshës*”, gjë që përbën një skemë të re pensionale, e cila nuk parashihet me nenin 4 të Ligjit bazik, dhe i cili nuk është ndryshuar përmes Ligjit të kontestuar. Andaj, sipas tij, mosdefinimi i këtij emërtimi e bën të paqartë Ligjin e kontestuar dhe e cenon edhe parimin e sigurisë juridike.

58. Ndërsa në anën tjetër, Kryeministri i Republikës së Kosovës i kundërshton të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se pretendimi i parë i parashtruesit të kërkesës, se “*Gjykata kishte urdhëruar largimin e periudhës kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare*” është i pasaktë, sepse Gjykata Kushtetuese vetëm kishte konstatuar se dallimi në trajtim i dy grupeve të ndodhura në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike nuk ishte proporcional. Kryeministri i Republikës së Kosovës, në përgjithësi argumenton se personat që i takonin grupit të punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, të zanatit, administratës, policisë, gjyqësorit dhe të tjerëve, tashmë trajtohen sipas kriterëve të përcaktuara përmes skemës parciale kontributpaguese të moshës, e të cilët nuk ishin përfshirë në skemën e plotë kontributpaguese të moshës. Në skemën e re, sipas Kryeministrit, integrohen personat nga grupi i parë dhe rikualifikohen personat nga grupi i dytë, duke i mënjeluar kështu dallimet në trajtim ndërmjet dy grupeve, gjersa lartësia e pensionit parcial do të paguhet në formë parciale, varësisht nga numri i viteve të kontributeve të paguara sipas Ligjit të ish-RSFJ-së, para 1 janarit 1999.
59. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe kundërgjykimet të dorëzuara nga Kryeministri, Gjykata në vijim do t'i elaborojë pretendimet ndërlidhur me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO190/19, për të vazhduar me pretendimin për shkelje të barazisë para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
60. Thënë këtë, Gjykata në vijim në mënyrë të përmbledhur do të rikujtojë konstatimet e saja në Aktgjykimin e saj KO190/19, të 30 dhjetorit 2022, ku objekt vlerësimi ishte Ligji Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (Ligji bazik).

II. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO190/19

A. Pretendimet dhe kundërgjykimet

61. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Ligji i kontestuar nuk ka marrë parasysh gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19, për shkak se sipas tij Gjykata në këtë rast kishte konstatuar se paragrafi 2 i nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit bazik në lidhje me nënparagrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues, sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së pagesës së Kontributeve (në testin e mëtejshëm: Udhëzimi administrativ), duhet të shfuqizohen si kundërkushtetuese, duke e detyruar Qeverinë dhe Kuvendin të ndërmerrnin veprimet e nevojshme për plotësimin e Ligjit bazik në përputhje me gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 15 korrik 2023. Në vijim

të kësaj, parashtruesi i kërkesës shton se qëllimi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO190/19, ka qenë largimi i kufizimit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar për stazhin kontributpagues, për qytetarët të cilët për shkak të largimit nga puna, si pasojë e masave të dhunshme, nuk kishin mundur të arrinin stazhin e kërkuar, para 1 janarit 1999. Në anën tjetër, Kryeministri përmes komenteve të tij të dorëzuara në Gjykatë kishte theksuar se një pretendim i tillë nuk është i saktë, sepse Gjykata vetëm kishte konstatuar se dallimi në trajtim i grupeve nuk ka qenë proporcional, ndërsa mënyra e adresimit të proporcionalitetit i është lënë në dorë pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, duke ia njohur hapësirën e vlerësimit në përcaktimin e politikave publike.

B. Përmbledhje e Aktgjykimit në rastin KO190/19

62. Gjykata rikujton se nëpërmjet kërkesës të referuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin 8 të nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, kjo e fundit kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligji bazik, në lidhje me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ [nr. 09/2015] për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues, me dyshimin se të njëjtat ishin në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në esencë, Gjykata Supreme bazuar në pesë (5) konteste në shqyrtim para saj dhe që ndërlidhen me të drejtën e palëve përkatëse për pension kontributpagues, kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit në lidhje me Udhëzimin Administrativ të aplikueshëm dhe të kontestuar në këtë rast, sa i përket kriterit të përvojës së punës në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh para 1 janarit 1999, në rrethanat historike dhe politike të viteve të 90-ta, përgjatë të cilave, pjesa dërmuese e të punësuarve ishin larguar nga vendet e tyre të punës, duke u bazuar në ligje diskriminuese.
63. Në këtë rast, Gjykata vë në pah se neni 8 i Ligjit bazik përcaktonte kushtet dhe kriteret që duhej plotësuar qytetari/ja i/e Republikës së Kosovës për të përfituar pension kontributpagues të moshës. Kushtet që duhej përmbushur ishin, si në vijim: (i) të arrijë moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; (ii) të ketë stazh pensional kontributdhënës të moshës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 të publikuar në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 26/83, para 1 janarit 1999; (iii) të ofrojnë dëshmi të vlefshme për pagesën e kontributeve, sipas dispozitave të Ligjit të KSAK-së, para 1 janarit 1999. Gjersa paragrafi 2 i nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) i Ligjit bazik, përcaktonte që: (iv) kategorizimi i shfrytëzuesve të këtij pensioni duhet të rregullohet me akt nënligjor, sipas a) kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, b) strukturës kualifikuese dhe c) kriterëve tjerë. Akti nënligjor, respektivisht Udhëzimit Administrativ, në nënparagrafin 2.3, paragrafi 2, të nenit 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues), përcaktonte se për njohjen e të drejtës në pension kontributdhënës të moshës, nevojitej përmbushja e stazhit pensional kontributdhënës pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, para 1 janarit 1999.
64. Gjykata, fillimisht trajtoi çështjet që ndërlidheshin me përcaktimin e kriterit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, i cili përbënte parakushtin që një qytetar/e i/e Republikës së Kosovës të përfitonte pension nga skema pensionale kontributpaguese e moshës. Në këtë kontekst, Gjykata vlerësoi se kriteri pesëmbëdhjetë (15) vjeçar ishte dhënë në mënyrë të nënkuptuar/jo të drejtpërdrejtë, përmes nënparagrafit 1.2 të nenit 8 të Ligjit bazik. Gjykata tutje kishte vlerësuar se nënparagrafët 1.2 dhe 1.3, të paragrafit 1, dhe paragrafi 2 i nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit bazik, dhe nënparagrafi 2.3 i nenit 6 i Udhëzimit Administrativ, duheshin lexuar së bashku dhe në harmoni me njëra-tjetrën, sepse përmes këtyre dispozitave përcaktohej: (i) se e drejta në pension kontributpagues të

moshës realizohet nga personat që kanë stazh pensional kontributpagues së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet, sipas Ligjit të ish-KSAK-së, para 1 janarit 1999; dhe të cilët duhet (ii) të ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve pensionale, sipas dispozitave të ligjit të ish-KSAK-së, para 1 janarit 1999 (shih, paragrafin 154 të Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19).

65. Gjykata, në këtë aspekt, kishte sqaruar se referenca në ligjet e lartcekura të ish-KSAK-së dhe ish-RSFJ-së, në të vërtetë buronte nga vet Ligji i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues. Megjithatë, Gjykata kishte sqaruar po ashtu se (i) kriteri që kjo skemë e pensioneve të ndërpritet në vitin 1999, ishte i saktësuar vetëm përmes Ligjit bazik të kontestuar, i cili merrte parasysh rrethanat politike të të njëjtit vit, përkatësisht vendosjen e Kosovës nën administrim ndërkombëtar sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ndërsa, (ii) kriteri për stazhin kontributdhënës pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, ishte përcaktuar vetëm përmes Udhëzimit Administrativ të kontestuar, bazuar në ligjet e lartcekura të ish-KSAK-së dhe ish-RSFJ-së (shih, paragrafin 157 të Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19).
66. Gjykata, në analizën e mëtejme vëren se pavarësisht kriterëve të lartcekura, Ligji bazik i kontestuar, përmes paragrafit 6 të nenit 8, kishte përcaktuar që (i) stazhi i punës për pension kontributdhënës të moshës, për periudhën 1989-1999, u njihet në mënyrë të drejtpërdrejt vetëm *“punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*, edhe pse të njëjtit nuk kanë paguar kontributet pensionale, sipas Ligjit përkatës të ish-KSAK-së, deri më 1 janar 1999, por kanë punuar *“në sistemin e Republikës së Kosovës”* (shih, paragrafin 159 të Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19). Megjithatë, Gjykata vëren se kjo e drejtë nuk u njihet kategorive të tjera të cilat ndodheshin në rrethana të ngjashme apo relativisht të ngjashme me kategorinë e lartcekur. Duke pasur parasysh këtë fakt, Gjykata kishte konstatuar se çështja kushtetuese që ngërthente kërkesa KO190/19, ishte të vlerësuarit (i) nëse punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, pozitat profesionale dhe të zanatit, administratës, të policisë, të gjyqësorit dhe të tjerëve, të cilëve nuk u njihet stazhi pensional për vitet 1989-1999 dhe u kërkohej dëshmi për periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, kontributdhënie, ishin diskriminuar *vis-à-vis* punëtorëve të (ii) arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, të cilëve u njihet stazhi pensional për periudhën 1989-1999, përmes paragrafit 6 të nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit bazik.
67. Në këtë kontekst, Gjykata bazuar në kriteret e nenit 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së dhe të nenit 55 të Kushtetutës vlerësoi: (i) nëse ka pasur dallime në trajtim mes këtyre kategorive, (ii) nëse dallimi në trajtim ka qenë i përcaktuar me ligj; (iii) nëse dallimi në trajtim, ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (iv) nëse dallimi në trajtim ishte i domosdoshëm dhe proporcional. Sa i përket kriterit të parë, (i) Gjykata kishte konstatuar se ka dallim në trajtim në mes dy grupeve/kategorive të qytetarëve dhe të cilët janë në situata të ngjashme dhe/ose analoge përkitazi me fushëveprimin e kategorisë së pensioneve kontributpaguese. Sa i përket kriterit të dytë (ii) Gjykata vlerësoi se dallimi në trajtim ndërmjet dy grupeve ishte i përcaktuar me ligj, përkatësisht nëpërmjet dispozitave të Ligjit bazik dhe Udhëzimit administrativ. Sa i përket kriterit të tretë (iii) Gjykata vlerësoi se kufizimi i përcaktuar me ligj ndiqte një qëllim legjitim, përderisa dallimi në trajtim kishte si qëllim mbrojtjen e sistemit ekonomik të vendit dhe ruajtjen e stabiliteti ekonomik. Mirëpo, sa i përket kriterit të katërt, (iv) Gjykata vlerësoi se kushti i përcaktuar nga Ligji bazik i kontestuar dhe Udhëzimi Administrativ i kontestuar, për të ofruar dëshmi se janë paguar kontributet së paku pesëmbëdhjetë (15) vite, deri më 1 janar 1999 nuk ishte i domosdoshëm dhe

proporcional, sepse: (i) nuk merrte parasysh aplikimin e ligjeve diskriminuese përgjatë viteve të 90-ta, (ii) zbatonte në mënyrë automatike dhe selektive kushtin e dëshmisë për pagesën e kontributeve prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vitesh, dhe atë vetëm ndaj (ii) *punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, gjyqësisë, policisë, administratës, pozitive profesionale dhe të zanatit, të cilët ishin larguar nga puna si rezultat i aplikimit të masave të dhunshme*, dhe të cilëve iu pamundësua pagimi i kontributeve pensionale, në periudhën 1989-1999, përderisa kategorisë së *“punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që punuan në sistemin paralel të Republikës së Kosovës”*, kjo e drejtë u njihej përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit bazik (shih, paragrafin 223 të Aktgjykimit në fjalë).

68. Ashtu siç është sqaruar në Aktgjykimin KO190/19, Gjykata kishte konstatuar se (i) kushtëzimi nëpërmjet dispozitës së kontestuar të Ligjit bazik për përfitimin e pensionit kontributpagues të moshës, përkundër faktit se përmes saj synohej arritja e një qëllimi legjitim, nuk ishte i domosdoshëm dhe proporcional. Kjo jo për faktin se kriteri pesëmbëdhjetë (15) vjeçar në vetvete ishte diskriminues, por për shkak se dispozita e kontestuar përjashtonte vetëm (i) punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, gjyqësisë, policisë, administratës, pozitave profesionale dhe të zanatit, nga përfitimi i pensionit kontributpagues të moshës, të cilëve si kategori po ashtu u ishte pamundësuar pagimi i kontributeve pensionale në vitet 1989-1999, për shkak të largimit të dhunshëm nga puna, si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese dhe i masave të dhunshme përgjatë viteve 1989-1999. Ky ishte thelbi i çështjes që Gjykata Kushtetuese e kishte trajtuar nëpërmjet Aktgjykimit të saj, në rastin KO190/19.
69. Si përfundim, Gjykata kishte vlerësuar, si në vijim: *“Duke qenë se Gjykata ka konstatuar se dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar (Ligji bazik) në lidhje me Udhëzimin Administrativ përkatës nuk janë në përputhje me Kushtetutën, i takon pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ që të përcaktojë kriteret proporcionale dhe të arsyeshme lidhur me fitimin e statusit të pensionistit kontributpagues.”* (shih, paragrafin 230 të Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO190/19).

C. Vlerësimi i Gjykatës

70. Bazuar në sa më lart, Gjykata sqaron sërish se nëpërmjet Aktgjykimit të saj, në rastin, KO190/19, shprehimisht ka kërkuar (i) eliminimin e diskriminimit ndërmjet (i) *“punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, gjyqësisë, policisë, administrativë, pozitive profesionale dhe të zanatit, dhe të tjerëve”* dhe (ii) *punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që punuan në sistemin e Republikës së Kosovës”*, e të cilëve u njihej stazhi pensional (përvoja e punës), për vitet 1989-1999. Për shkak të këtij diskriminimi dhe joproporcionaliteti ndërmjet dy kategorive, Gjykata kishte konkluduar se paragrafi 2 i nenit 8 i Ligjit bazik të kontestuar, në lidhje me paragrafin 6.2 të nenit 6 të Udhëzimit administrativ të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, duke e urdhëruar Kuvendin dhe Qeverinë që të ndërmerrnin veprime konkrete për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik, në përputhje me gjetjet e Gjykatës.
71. Gjykata rikujton se përmes Aktgjykimit të saj, në rastin KO190/19, e njëjta nuk e kishte shfuqizuar kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për njohjen e të drejtës në *“pension kontributpagues të moshës”*, por kishte konstatuar se stazhi i punës (përvoja) për pensionin kontributpagues të moshës, për vitet 1989-1999, në mënyrë proporcionale, duhet t’u njihej edhe punëtorëve tjerë, të cilët si rezultat i ligjeve diskriminuese dhe masave të dhunshme u dëbuan nga puna përgjatë kësaj dekade.

72. Thënë këtë, bazuar dhe në sqarimet e lartcekura, Gjykata vlerëson se kjo çështje në aspektin kushtetues është ezauruar, përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO190/19, të 30 dhjetorit 2022, sepse në mënyrë të nënkuptuar Gjykata e kishte legjitimuar kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, si parakusht për përfitimin e pensionit nga skema kontributpaguese e moshës, duke ia njohur Ligjvënësit dhe Qeverisë qëllimin legjitim, që kishte për qëllim të arrinte nëpërmjet këtij kushtëzimi kohor, andaj Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta rihapë tutje këtë çështje tashmë të legjitimuar.

III. Vlerësimi i përputhshmërisë së nenit 8A, i shtuar pas nenit 8 në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së

73. Duke marrë parasysh shtjellimet e mësipërme që i referohen çështjes kushtetuese në kërkesën KO190/19, dhe çfarë përfaqëson çështja kushtetuese në kërkesën e tanishme KO35/24, të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata në vijim do të analizojë nëse përmes dispozitave të nenit 8A, të cilat janë shtuar në Ligjin bazik nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, Ligjvënësi ka përfshirë në skemën pensionale kontributpaguese të moshës, përveç tjerash edhe kategorinë e diskriminuar, përkatësisht (i) punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, gjyqësisë, policisë, administratës, pozitat profesionale, të zanatit dhe të tjerëve që ndodheshin në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, në raport me (ii) punëtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që punuan në sistemin e Republikës së Kosovës.
74. Bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson se fushëveprimi i kësaj kërkeje, respektivisht çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën, e Ligjit të kontestuar, përkatësisht vlerësimi nëse dispozitat ligjore të nenit 8A të shtuara pas nenit 8 në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me parimin e “barazisë para ligjit” të garantuar nëpërmjet dispozitave të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
75. Andaj, në këtë kontekst, Gjykata do të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

A. Pretendimet dhe kundërgargumentet

76. Parashtruesi i kërkesës thekson se kriteri pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, ua mohon pensionistëve të drejtën e realizimit të pensionit kontributpagues të moshës, të cilët nuk e arrijnë kriterin e përcaktuar me Ligjin e kontestuar, duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë ata para ligjit dhe që një kufizim i tillë, ndikon jo vetëm në pensionin kontributpagues të moshës, por edhe në skemat e tjera, si pensionet familjare që trashëgohen nga familjarët e të punësuarit, i cili po ashtu duhet t'i ketë pasur pesëmbëdhjetë (15) vjet stazh kontributpagues, në mënyrë që familjarët e tij/saj të përfitojnë nga kjo skemë pensionale. Kryeministri në komentet e tij lidhur me pretendimin që personat që nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, si rezultat i largimit nga puna nëpërmjet ligjeve diskriminuese ose nëpërmjet masave të dhunshme, nuk përfitojnë nga pensioni shtetëror i paguar nga buxheti i Republikës së Kosovës, thekson se një konstatim i tillë nuk është i saktë, sepse Ligji i

kontestuar në nenin 8/A, i kualifikon personat të cilët janë larguar nga puna gjatë viteve të 90-ta, si rezultat i ligjeve diskriminuese ose i masave të dhunshme, në skemën e “*pensionit parcial kontributpagues të moshë*”, mirëpo, për këta persona, kushti i ri i vendosur në pajtim me parimin e proporcionalitetit dhe qëllimit legjitim, është të dëshmojnë periudhën kushtëzuese pesëmbëdhjetë (15) vjeçare në formë kumulative.

B. Parimet e përgjithshme

77. Gjykata fillimisht thekson që bazuar në (i) nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, një nga vlerat e Republikës është edhe drejtësia sociale; (ii) nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet, ndër të tjera, në bazë të gjendjes ekonomike apo sociale; dhe (iii) nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, (a) kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj; dhe (b) sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj. Bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata vë theks në faktin që Kushtetuta përmes nenit 51 të saj, çështjet që ndërlidhen me kujdesin shëndetësor, sigurimin social, përfshirë atë që ka të bëjë me “papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë”, i ka deleguar në nivel të ligjit dhe i cili miratohet nga Kuvendi i Republikës, gjithnjë nën garancitë kushtetuese, përfshirë ato që ndërlidhen me drejtësinë sociale dhe barazinë para ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 7 dhe 24 të Kushtetutës (shih rastin e Gjykatës KO158/23, parashtrues Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore, Aktgjykim i 19 qershorit 2024, paragrafët 128-129.
78. Në këtë kuptim, Gjykata potencon ingjencën kryesore kushtetuese të Kuvendit për ligjëvënie në nivel vendi, duke theksuar se Kuvendi, si pushtet legjislativ, “*përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, [...] nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër*” (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO72/20](#), parashtrues Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 28 majit 2022, paragrafi 352). Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, është i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrimin e kompetencës së tij, bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, të rregullojë nëpërmjet ligjeve skema pensionale me qëllim të garantimit të mirëqenies për të gjitha kategoritë e pensionistëve që përfitojnë pension nga skemat pensionale të financuara nga Shteti. Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet interesit të Republikës së Kosovës.
79. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata, siç ka përcaktuar përmes praktikës së saj gjyqësore, fillimisht rikujton se neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, përcakton që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe që të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore. Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, e ndalon diskriminimin jo vetëm ndaj të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, por edhe ndaj të drejtave të cilat janë të përcaktuara përmes ligjeve të aplikueshme. Për më tepër dhe në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë në pah se fushëveprimi i këtij neni është i gjerë dhe shtrihet edhe në garantimin e ndalimit të diskriminimit, jo vetëm sa i përket të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por edhe atyre me ligj. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve për cenimin e këtij neni, duhet të bëhet përtej garancive të nenit 14 të KEDNJ-së dhe të përfshijë edhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së (shih, në lidhje me këtë, rastin e Gjykatës, [KO93/21](#), parashtrues Blerta Deliu-Kodra dhe dymbëdhjetë (12) 37

deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2021, paragrafët 283-293; dhe rastin e Gjykatës [KO79/23](#), me parashtrues, Avokati i Popullit, vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Aktgjykim, i 26 dhjetorit 2023, paragrafët 353-354).

C. Vlerësimi i Gjykatës

80. Referuar përmbajtjes së nenit 1 (Qëllimi) të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se qëllimi i Ligjvënësit ishte ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit bazik, respektivisht i Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ligji bazik në nenin 4 (Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj), të tij përcakton: (i) të drejtën në pension bazik të moshës; (ii) të drejtën në pension kontributpagues të moshës; (iii) të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar; (iv) të drejtën në pension të parakohshëm; (v) të drejtën në pension invalidor të punës; dhe (vi) të drejtën në pension familjar. Ndërsa, nenet pasuese të Ligjit bazik përcaktojnë kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension, për secilën kategori të lartcekur, përfshirë procedurat administrative që duhet ndjekur nga aplikuesit përkatës, për njohje të së drejtës në pension, duke saktësuar afatet për parashtrimin e kërkesave dhe të ankesave lidhur me njohjen/përkatësisht mosnjohjen e të drejtës për të përfituar nga skemat pensionale.
81. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet përmbajtjes së dispozitave të nenit 8A (Pensioni parcial kontributpagues i moshës), i shtuar në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar dhe vëren se ky nen në të vërtetë e plotëson nenin 8 të Ligjit bazik dhe përbëhet prej katër (4) paragrafëve dhe katër (4) nënparagrafëve.
82. Paragrafi 1 i nenit 8A, përcakton: *“1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999, por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute, si periudhë kushtëzuese, për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen.”*
83. Paragrafi 2 i nenit 8A, përcakton: *“2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim: 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme; 2.4. shumën e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.”*
84. Paragrafi 3 i nenit 8A, përcakton: *“3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri.”*
85. Ndërsa, paragrafi 4 i nenit 8A, përcakton: *“4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.”*
86. Gjykata vë në pah se nëpërmjet paragrafit 1 të nenit 8A, të shtuar në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, Ligjvënësi ka krijuar një skemë të re pensionale, e cila tashmë ua njeh të drejtën në pension kontributpagues të moshës, edhe kategorive të diskriminuara, respektivisht (i) punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore,

administratës, gjyqësisë, policisë, pozitave profesionale, të zanatit dhe të tjerëve, të cilët nuk e arrinin kushtin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, të stazhit pensional, për shkak se u kërkohej dëshmi për kontributet e paguara për vitet 1989-1999, edhe përkundër faktit se edhe kjo kategori e punëtorëve ishin larguar nga puna përgjatë kësaj dekade, si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese dhe i masave të dhunshme.

87. Paragrafi 2 i nenit 8A, përcakton qartë se të drejtën në "*pension parcial kontributpagues të moshës*" e gëzojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, që plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas nënparagrafëve 2.1, 2.2 dhe 2.3 të nenit 8A. Më saktësisht, për të përmbushur kushtet për pension kontributpagues, sipas këtyre dispozitave, qytetari/ja i/e Republikës së Kosovës, duhet: (i) të arrijë moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; (ii) të ofrojë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve, para 1 janarit 1999; dhe (iii) të ofrojë dëshmi të largimit të tij/saj nga puna, pas 1 janarit 1989 - deri më 1 janar 1999. Me këtë rregullim, neni 8 i Ligjit bazik, i plotësuar nëpërmjet nenit 8A, tashmë nuk kërkon (i) dëshmi për pagesën e kontributeve për vitet 1989-1999, por (ii) dëshmi për largim nga puna përgjatë kësaj dekade për të faktuar pamundësinë objektive për të kontribuar në skemën pensionale kontributpaguese të moshës, si rezultat i rrethanave të krijuara në atë periudhë kohore.
88. Për dallim nga nënparagrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3 të nenit 8A, të cilët përcaktojnë kritere për t'u kualifikuar për "*pension parcial kontributpagues të moshës*", nënparagrafi 2.4 i këtij neni, përcakton që: (i) kontributet e paguara para 1 janarit 1999, respektivisht para 1 janarit 1989; dhe (ii) periudha e largimit nga puna, pas 1 janarit 1989 - deri më 1 janar 1999, të marra së bashku arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh të stazhit pensional. Ky kusht vlen njëjtë për të gjitha kategoritë që nuk arrinin të dëshmonin stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, përmes pagesës së kontributeve, para 1 janarit 1999 për shkak të largimit të dhunshëm nga puna.
89. Kjo mënyrë e kategorizimit nënkupton që kategoritë e personave të cilët nuk kanë mundur të arrijnë kushtin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për të përfituar pensionin e "*plotë*" kontributpagues të moshës, sipas kritereve të përcaktuara përmes nenit 8 të Ligjit bazik, do të rikualifikohen në skemën "*parciale*" kontributpaguese të moshës, sipas kritereve të përcaktuara përmes nenit 8A, të shtuar në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, duke lëvizur nga (i) skema aktuale e pensionit "*bazë të moshës*", në një nivel më të lartë të pagesës, (ii) përkatësisht në përfitimin e pensionit "*parcial*" kontributpagues të moshës.
90. Për të qartësuar me tej skemat e përfitimeve të pensioneve, Gjykata në vazhdim dhe bazuar në normat ekzistuese ligjore, vëren se Ligjvënësi i ka ndarë përfituesit e pensioneve, përkatësisht të skemave pensionale në tre (3) kategori:
- (i) Në kategorinë e parë (skema pensionale kontributpaguese e moshës) bëjnë pjesë: (i) personat të cilët pandërprerë kanë plotë pesëmbëdhjetë (15) vite; a) përvojë pune, dhe b) kontribute pensionale të paguara, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83) para 1 janarit 1999;
- (ii) Në kategorinë e dytë (skema parciale kontributpaguese e moshës) bëjnë pjesë: (i) personat të cilët plotësojnë kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për sa i përket; a) përvojës së punës, por që nuk kanë arritur të përmbushin kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar; b) të kontributeve pensionale të paguara, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83), para 1 janarit 1999, për shkak të dëbimit nga vendet e tyre të punës, si pasojë e aplikimit të ligjeve diskriminuese përgjatë viteve 1989-1999.

- (iii) Në kategorinë e tretë (pensioni bazik i moshës), bëjnë pjesë: (i) personat që janë punësuar, pas 1 janarit 1984, dhe të cilët nuk plotësojnë kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar; a) të përvojës së punës, pavarësisht se mund të kenë kontribute të paguara pas kësaj periudhe. Respektivisht në këtë kategori bëjnë pjesë të gjithë pensionistët, që nuk i kanë pesëmbëdhjetë (15) vite, a) përvojë pune dhe të gjithë qytetarët e rëndomtë që nuk kanë fare përvojë pune, por që kanë arritur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare.
91. Marrë parasysh skemat e rregulluara me dispozitat e nenit 8 të Ligjit bazik, si më lart Gjykata vëren se Ligjvënësi ka ofruar një skeme të re kontributpaguese të moshës, atë “parciale” e cila është më gjithëpërfshirëse se ajo ekzistuese, për faktin se përfshinë pa dallim të gjithë personat nga grupi i parë dhe grupi i dytë, përkatësisht të dëbuarit nga puna përgjatë viteve 1980 - 1999, si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese dhe i masave të dhunshme, duke evituar kështu trajtimin e pabarabartë mes dy kategorive të ndodhura në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, siç ishte para këtij rregullimi ligjor. Më saktësisht përmes rregullimit të ri ligjor, Ligjvënësi i ka lëvizur (i) punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, administrative, gjyqësive, policisë, pozitat profesionale, të zanatit dhe të tjerëve, nga skema (i) “bazike” e pensionit të moshës, në skemën (ii) “parciale” kontributpaguese të moshës, duke evituar kështu diskriminimin mes tyre dhe (ii) punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, dhe duke përcaktuar lartësinë të pensionit, në varësi të kontributeve të paguara, para 1 janarit 1999.
92. Bazuar në plotësimet e bëra në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, i cili shton dispozitat e nenit 8A në Ligjin bazik, Gjykata vlerëson se Ligjvënësi: (i) tashmë përfshinë të gjithë personat nga grupi i parë dhe i dytë, të cilët nuk mund të arrinin pesëmbëdhjetë (15) vite, për sa i përket a) përvojës së punës dhe b) pagesës së kontributeve, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83), para 1 janarit 1999, për shkak të dëbimit nga puna, si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese dhe i masave të dhunshme; (ii) heqë kushtin për të dëshmuar vitet a) e kontributeve të paguara, duke e zëvendësuar këtë kusht me b) dëshminë e largimit nga puna, për periudhën 1989 – 1999, dhe (iii) përcakton lartësi proporcionale të pensionit, sipas viteve të kontributeve të paguara, para 1 janarit 1999, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83).
93. Për më tepër, Gjykata vëren se Ligjvënësi përmes Ligjit të kontestuar në fakt ka fshirë në tërësi paragrafin 6 të nenit 8 të Ligjit bazik, në emër të largimit të diskriminimit, mes këtyre dy kategorive, duke shtuar dispozita tjera të reja përmes nenit 8, të cilat parashohin një kompensim tranzitor, afërsisht tre (3) vjeçar, në rast të reduktimit të lartësisë së pensionit, nëse kalohet nga skema kontributpaguese e moshës, në skemën parciale, sipas kriterëve të përcaktuara përmes dispozitave të nenit 8A.
94. Megjithatë, pavarësisht krijimit të kësaj skeme të re kontributpaguese të moshës, parashtruesi i kërkesës pretendon se nënparagrafi 2.4 i nenit 8A, i shtuar në Ligjin bazik nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar nuk e ka hequr kushtin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për të përfituar pension kontributpagues të moshës dhe se kjo dispozitë e shtuar në Ligjin bazik bie në kundërshtim me barazinë para ligjit të garantuar me Kushtetutë dhe KEDNJ.
95. Në këtë kontekst, Gjykata duke marrë për bazë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, në rastet kur kjo e fundit ka vlerësuar nëse e drejta për “barazi para ligjit” e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, është kufizuar përkitazi me a) kriteret e përfitimit të pensionit parcial kontributpagues të moshës, dhe b) përcaktimin e lartësisë

së pensionit, bazuar në vitet kontributdhënëse, para 1 janarit 1999, në vijim do të aplikojë testin e diskriminimit që buron nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së, duke vlerësuar nëse ekziston (i) “dallimi në trajtim” mes personave të dy kategorive të përfshira në skemën parciale kontributpaguese të moshës, (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ndjekë një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që është synuar të arrihet me plotësim-ndryshimin e Ligjit bazik (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI45/20](#) dhe [KI46/20](#), parashtrues, *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykim i 26 marsit 2021, paragrafi 85; shih, gjithashtu rastin [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 300).

(i) Nëse ka “dallim në trajtim”

96. Në kontekst të vlerësimit nëse personat nga grupi i parë dhe i dytë, për sa i përket a) kritereve dhe b) lartësisë së pensionit, trajtohen ndryshe përmes dispozitave të nenit 8A, përkatësisht përmes nënparagrafit 2.4 dhe paragrafin 4 të këtij neni, Gjykata rithekson se bazuar në nenin 24 të Kushtetutës dhe në nenet e lartcekura të KEDNJ-së, dhe siç është sqaruar më tej përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, jo çdo “dallim në trajtim” përbën diskriminim. Dallimi në trajtim rezulton në diskriminim nëse i njëjti nuk ka “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”. Prandaj, në vlerësimin nëse, rrethanat e një rasti, kanë rezultuar në diskriminim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, fillimisht përcakton që duhet të vlerësohet nëse ka “dallim në trajtim” të personave në “situata analoge ose relativisht të ngjashme” (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 74).
97. Gjykata në vijim vlerëson, nëse në rrethanat e rastit konkret, kemi “dallime në trajtim” të personave të ndodhur në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”, dhe nëse po të vazhdojë më tej me aplikimin e testit të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, për të konstatuar nëse dallimi në trajtim ndjek “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” ose jo (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 302).
98. Në këtë kontest, Gjykata thekson se ekziston “dallimi në trajtim”, mes personave të ndodhur në situata analoge ose relativisht të ngjashme, për sa i përket (a) kritereve për t’u kualifikuar në “skemën parciale kontributpaguese të moshës” dhe (b) lartësisë së pensionit, sipas viteve të kontributdhënies. Ky dallim qëndron në faktin se personat që janë punësuar, pas 1 janarit 1984, dhe të cilët nuk plotësojnë kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për sa i përket a) përvojës së punës, pavarësisht se mund të kenë edhe katërmëdhjetë (14) vite kontribute të paguara, nuk mund të përfitojnë pension nga kjo skemë e re pensionale. Respektivisht në këtë kategori bëjnë pjesë të gjithë pensionistet, që nuk mund të përmbushin kumulativisht kriteret sipas nënparagrafit 2.2 dhe 2.3 të nenit 8A.
99. Në dritën e këtij konstatimi, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse “dallimi përkatës në trajtim”: (a) është i përcaktuar me ligj; (b) nëse i njëjti ndjekë një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës së individit dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet kufizimit me ligj (shih, në këtë kontekst, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), me parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 311).

a) Nëse dallimi në trajtim është i “përcaktuar me ligj”

100. Gjykata, bazuar në paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës, por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, rithekson se kufizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet *“vetëm me ligj”*, që nënkupton, ndër të tjera, që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj ku parashihen kufizime, mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është *“përcaktuar me ligj”*. Ky paragraf rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të përcaktuar se a është kushtetues një *“kufizim”* i të drejtave dhe lirive themelore apo jo (shih, në mënyrë specifike, qëndrimin e Gjykatës në rastin [KO54/20](#), parashtrues, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 192). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkthimi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 312).
101. Sa i përket parimeve të përgjithshme që ndërlidhen me kriterin e *“përcaktueshmërisë me ligj”*, Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë, fillimisht kuptimin e termit *“ligj”* nga pikëpamja e kufizimit të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se sipas praktikës së GJEDNJ-së, kjo e fundit gjithmonë e ka kuptuar termin *“ligj”* në kuptimin *“përmbajtësor”*, dhe jo në atë *“formal”*. Në këtë kontekst, termi *“ligj”* përfshin ligjet dhe aktet më të ulëta se ligjet, apo aktet nënligjore, si dhe masat e ndërmarra nga autoritetet rregullatore profesionale bazuar në kompetencat e tyre të deleguara nga Kuvendi. Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, *“ligji”* duhet kuptuar që të përfshijë ligjet *“statutore”*, por gjithashtu edhe *“aktet nënligjore”* dhe *“precedentet gjyqësore”*. Si përmbledhje, termi *“ligj”* janë dispozitat në fuqi ashtu si i kanë interpretuar gjykatat (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së [Gulcu kundër Turqisë](#), nr. 17526/10, Aktgjykim i 19 janarit 2016, paragrafi 104; dhe [Leyla Şahin kundër Turqisë](#), nr. 44774/98, Aktgjykim i 10 nëntorit 2005, paragrafi 84; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI27/20](#), parashtrues *Lëvizja Vetëvendosje!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 68).
102. Gjykata në vijim do të paraqesë rastet e GJEDNJ-së, ku përmes praktikës gjyqësore është shtjelluar kriteri *“i përcaktuar me ligj”*, dhe mënyrën se si GJEDNJ e analizon se a është një kufizim ose *“ndërhyrje”* e ndërmarrë e përcaktuar me/në ligj apo jo. Ndonëse çështjet faktike të atyre rasteve dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, i rëndësishëm ngelet interpretimi i përgjithshëm i kriterit *“i përcaktuar me ligj”*, që GJEDNJ i referohet në praktikën e saj gjyqësore. Ky interpretim i GJEDNJ-së është afirmuar edhe në praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KO131/12](#), parashtrues, *Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 15 marsit 2013; [KO108/13](#), parashtrues, *Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 3 shtatorit 2013; [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart; [KO157/18](#), parashtrues *Gjykata Supreme*, cituar më lart; [KO54/20](#), parashtrues, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, cituar më lart; dhe, [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart).
103. GJEDNJ ka theksuar se: *“shprehja “në pajtim me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai duhet të jetë i arritshëm për personat në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij.”* Më tutje, GJEDNJ, kishte theksuar se: *“një rregull është “i parashikueshëm” kur siguron një masë të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike” dhe se një ligj “i cili jep një diskrecion duhet të tregojë fushën e këtij diskrecioni, megjithëse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen respektuar jo domosdoshmërisht duhet të përfshihen*

në rregullat e së drejtës materiale.” (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [Tommaso kundër Italisë](#), nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty).

104. Gjykata në kontekst të vlerësimit të “përcaktueshmërisë me ligj”, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se ky kriter duhet të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) ekzistimi i një baze të qartë ligjore; (ii) parashikueshmërinë e kufizimit përkatës (shih rastin e GJEDNJ-së [Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë](#), nr. 3753/05, Aktgjykim i 15 tetorit 2015, paragrafi 109); (iii) ekzistencën e masave mbrojtëse nga ndërhyrja, përkatësisht kufizimi i të drejtave nga autoritetet publike; dhe (iv) qartësinë e mjaftueshme në ligj përkitazi me diskrecionin e autoritetit publik lidhur me mundësinë e kufizimit dhe mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni (shih rastin e GJEDNJ-së, [Navalnyy kundër Rusisë](#), nr. 29580/12, 36847/12, 11252/13, 12317/13, 43746/14, Aktgjykim i 15 nëntorit 2018, paragrafët 115-119).
105. Në rastin KO01/17 të Gjykatës, në paragrafin 90, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se kufizimi i tillë është në përputhje me kërkesat e përfshira në nenin 55.1 të Kushtetutës, dhe për pasojë përfundoi se kufizimi i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me ligj.” (shih [KO01/17](#), parashtrues Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit, cituar më lart, paragrafi 90).
106. Në rastin e Gjykatës KO157/18, në paragrafët 93-96, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Kushtetuta në kapitullin II të saj iu ka dhënë rëndësi të posaçme të drejtave dhe lirive të njeriut dhe gjithashtu ka paraparë edhe rastet kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe i Shtetit”. Ndërkaq, në paragrafët vijues ku edhe e kishte bërë analizën se për rrethanat e atij rasti a ishte kufizimi i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Sa i përket kufizimit të paraparë me ligj, Gjykata vëren se kufizimi i të drejtave në rastin konkret ishte paraparë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili ishte miratuar nga Kuvendi, më 10 qershor 2010, institucion të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Prandaj, nisur nga fakti se një e drejtë e garantuar me kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet me ligj, kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtave është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1, të nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se obligimi i kompanive të sigurimit për të pagur një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, në rastin konkret, ka qenë i paraparë me ligj.” (shih rastin [KO157/18](#), parashtrues, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, cituar më lart, paragrafët 95-96).
107. Në rastin KO108/13, në paragrafët 133-134, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata i ishte referuar rastit të GJEDNJ-së, [Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë](#) (Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 7 qershorit 2012), dhe kishte theksuar se: “[...] një normë nuk mund të konsiderohet si një ‘ligj’ përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. [...]” (shih rastin e Gjykatës [KO108/13](#), parashtrues Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart).

108. Në rastin KO131/12, në paragrafin 130, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: *“Kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.”* (shih rastin e Gjykatës [KO131/12](#), parashtrues *Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart).
109. Në rastin KO93/21, në paragrafin 312, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: *“Bazuar në paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet “vetëm me ligj”, që nënkupton, ndër të tjera, që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj ku parashihen kufizime, mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është “përcaktuar me ligj”. Ky paragraf rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të përcaktuar se a është kushtetues një “kufizim” i të drejtave dhe lirive themelore apo jo”* (shih rastin e Gjykatës [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 312).
110. Gjykata, në vazhdim rikujton që kategoria e pensionistëve që gëzojnë pension nga skema parciale kontributpaguese e moshës, është e përcaktuar përmes dispozitave të nenit 8A. Bazuar në këto dispozita, Gjykata thekson që “dallimi në trajtim” ndërmjet personave të ndodhur në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”, për sa i përket a) kriterëve për t’u kualifikuar në “skemën parciale kontributpaguese të moshës” dhe b) lartësisë së pensionit është i përcaktuar nëpërmjet paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 8A, i shtuar në Ligjin bazik, pas nenit 8, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar.
111. Në vijim të këtij konstatimi, Gjykata duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse “dallimi në trajtim” i lartcekur dhe i “përcaktuar me ligj”, ndjekë një “qëllim legjitim”, dhe nëse masat e ndërmarra nga Ligjvënësi dhe Qeveria për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik, nëpërmjet dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar janë proporcionale me qëllimin që është synuar të arrihet.
- b) Nëse ka një “qëllim legjitim”
112. Gjykata, bazuar në paragrafin 3 të nenit 55 të Kushtetutës, por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, rithekson që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë *“nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.”* Sipas këtij paragrafi, në parim, rezulton që, qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të përcaktuara dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin në të cilin është lejuar kufizimi në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës (shih, në këtë kuptim, rastin e Gjykatës [KO54/20](#), cituar më lart, paragrafi 193). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t’i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), me parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 333).
113. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme, thekson se në mënyrë që të arsyetohet dallimi në trajtim, sipas GJEDNJ-së kufizimi apo dallimi në trajtim, duhet të ketë një *“justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”*, përkatësisht të jetë i bazuar në një qëllim legjitim (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, [Molla Sali kundër Greqisë](#), nr. 20452/14, Aktgjykim i 18 qershorit 2020, paragrafi 135; dhe [Fabris kundër Francës](#),

nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së shtetet duhet që të dëshmojnë që ekziston një marrëdhënie në mes të qëllimit legjitim të synuar dhe dallimit në trajtim të pretenduar nga parashtruesit përkatës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Ünal Tekeli kundër Turqisë](#), nr. 29865/96, Aktgjykim i 16 nëntorit 2004, paragrafi 66).

114. GJEDNJ ka identifikuar se qëllimi legjitim, ndër të tjera, mund të përfshijë por nuk është i kufizuar në: (i) rivendosjen e paqes (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), cituar më lart, paragrafi 45); (ii) mbrojtjen e sigurisë kombëtare (shih, rastin e GJEDNJ-së [Konstatin Markin kundër Rusisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 137); (iii) ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe ristrukturimin e borxhit në kontekst të krizës serioze politike, ekonomike dhe sociale (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mamatas dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 63066/14, 64297/14, 66106/14, Aktgjykim i 21 korrikut 2016, paragrafi 103); apo (iv) mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (shih rastin e GJEDNJ-së [Napotnik kundër Rumanisë](#), nr. 33139/13, Aktgjykimi i 10 janarit 2021, paragrafët 79 dhe 86).
115. Gjykata rikujton se Ligjvënësit dhe Qeverisë kjo e fundit ia kishte njohur “qëllimin legjitim” për sa i përket përcaktimit me “ligj” të kriterit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, nëpërmjet Aktgjykimit të saj, në rastin KO190/19 dhe se ky kriter për sa i përket përmbushjes së stazhit pensional (përvojës), por jo edhe kontributeve të paguara, para vitit 1999, vazhdon të mbetet në fuqi nëpërmjet nënparagrafit 2.4 të paragrafit 2 të nenit 8A, i shtuar në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar.
116. Kjo dispozitë e re e shtuar në Ligjin bazik, ndër të tjera përcakton që: (i) kontributet e paguara para 1 janarit 1999, dhe (ii) periudha e largimit nga puna, pas 1 janarit 1989 - deri më 1 janar 1999, të marra së bashku arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh të stazhit pensional. Ligjvënësi, nëpërmjet kësaj dispozite ka synuar eliminimin e diskriminimit që ekzistonte më parë, ndërmjet grupit të parë dhe grupit të dytë të pensionistëve, dhe ky qëllim është arritur përmes plotësimit-ndryshimit të nenit 8 të Ligjit bazik, përmes amendamentimit të tij, ku është shtuar neni 8A, në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar.
117. Gjykata, rikujton sërish faktin se përcaktimi i kriterit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, për të dëshmuar stazhin pensional është trajtuar nga Gjykata, në rastin KO190/19, dhe është konsideruar se një përcaktim i tillë, ndjek një “qëllim legjitim”, qëllimi i të cilit ishte mbrojtja e të drejtave të personave të tjerë dhe siguri i një stabiliteti ekonomik të vendit. Gjykata kishte theksuar se përcaktimi i kriterit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, kishte të bënte me faktin që Kosova ishte pjesë e sigurimit pensional dhe invalidor të ish-Jugosllavisë, ku sipas të njëjtit kërkohej që përfituesi i pensionit kontributpagues, të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite stazh kontributdhënës, për realizimin e kësaj të drejte bazuar në ligjin e ish-KSAK-së. Ky kriter ishte bërë pjesë e legjislacionit të Republikës së Kosovës, në vitin 2014, kur Kuvendi miratoi Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, gjersa kriteret shtesë për realizimin kësaj të drejte u vendosën përmes Udhëzimit Administrativ.
118. Gjykata tashmë ka legjitimuar faktin se “dallimi në trajtim” të cilin e ka aplikuar Kuvendi dhe Qeveria, nëpërmjet dispozitave të nenit 8 të Ligjit bazik, ka ndjekur një “qëllimin legjitim”, i cili u vlerësua se ishte gjerësisht i pajtueshëm me objektivat e përgjithshme, përkatësisht i kontribuonte mbrojtjes së stabilitetit ekonomik të vendit, pasi Republika e Kosovës u përball me një tërësi sfidash të lidhura me nevojën për të ngritur një sistem të qëndrueshëm të sigurimeve shoqërore, i kushtëzuar po ashtu edhe me kapacitetin e reduktuar buxhetor të vendit. Gjykata sqaron se ky qëllim legjitim vazhdon t'i njehet Kuvendit dhe Qeverisë, edhe për sa i përket dispozitave të shtuara në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, i cili si i tillë është në pajtueshmëri

me objektivat legjitime të vendit, interesin e përgjithshëm dhe garanton stabilitet ekonomik në Republikën e Kosovës.

119. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, dhe marrë parasysh faktin që: (i) ekziston “*dallimi në trajtim*” mes personave të ndodhur në “*situata analoge ose të ngjashme*”, për sa i përket kritereve të përcaktuara, përmes dispozitave të nenit 8A, të shtuara në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar; (ii) se kufizimi është i “*përcaktuar me ligj*”; dhe (iii) se i njëjti ndjek një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht atë të ruajtjes së stabilitetit ekonomik të vendit, në vijim, Gjykata do të vlerësojë (iv) nëse ka pasur një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis qëllimit legjitim të lartpërmendur dhe mjeteve të përdorura, për këtë qëllim.

c) Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet

120. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës, por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, ku është përcaktuar se me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet përgjegjësi kushtetuese për autoritetet publike që gjatë interpretimit dhe vendosjes në rastet para tyre, t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim sa më të vogël (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KO157/18, me parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, të cituar më lart, paragrafi 102). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t’i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 346).
121. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme në ndërlidhje me proporcionalitetin, vendos theksin te fakti (i) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit, ndërmjet a) kufizimit të së drejtës dhe b) qëllimit që synohet të arrihet përmes tij. Në dritën e këtij kriteri, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës ka theksuar se dallimi në trajtim kërkon një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe respektimit të të drejtave të individëve. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka specifikuar se dallimi në trajtim kërkon një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis masës së ndërmarrë dhe qëllimit që synohet që të arrihet (shih rastet e GJEDNJ-së, [Molla Sali kundër Greqisë](#), cituar më lart, paragrafi 135; [Fabris kundër Francës](#), nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56; [Mazurek kundër Francës](#), nr. 34406/97, Aktgjykim i 1 shkurtit 2000, paragrafët 46 dhe 48; dhe [Larkos kundër Qipros](#), nr. 29515/95, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 29). Përgjatë kësaj vije argumentuese, GJEDNJ në rastin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* kishte theksuar se: “[...] diskriminim do të thotë trajtim i pabarabartë, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, i personave në rrethana të ngjashme. Mungesa e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, nënkupton që dallimi nuk ndjekë një qëllim legjitim, ose që nuk ka marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimeve që dëshirohet të arrihen” (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Sejdić dhe Finci kundër Bosnjë dhe Hercegovinës](#), cituar më lart, paragrafi 42).
122. Gjykata gjithashtu rikujton që GJEDNJ ka vënë gjithashtu në pah se nuk është roli i saj që të zëvendësojë autoritetet kompetente vendore në vlerësimin se deri në cilën masë dallimet në situata të ngjashme kanë justifikuar një dallim në trajtim dhe se në raste të tilla shtetet gëzojnë një hapësirë të vlerësimit (*margin of appreciation*). Fushëveprimi i kësaj hapësire të vlerësimit, sipas GJEDNJ-së do të jetë në varësi të rrethanave, objektit të vlerësimit dhe specifikave të rastit (shih rastet e GJEDNJ-së: [Molla Sali](#)

[kundër Gregisë](#), cituar më lart, paragrafi 136; dhe [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 61).

123. Në njërën anë, GJEDNJ ka specifikuar disa fusha ku hapësira e vlerësimit vazhdon të jetë e gjerë. Për shembull, GJEDNJ ka theksuar se për shkak të njohurisë së shoqërisë dhe nevojave të saja, autoritetet vendore në parim janë në pozicion më të mirë se gjyqtarët ndërkombëtarë të vlerësojnë se çka është në interes publik në aspektin ekonomik dhe social, dhe GJEDNJ do të respektojë zgjedhjen e ligjvënësit përveç nëse është qartazi pa bazë të arsyeshme (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Belli and Arquier-Martinez kundër Zvicrës](#), nr. 65550/13, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 94; [Burden dhe Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 13378/05, Aktgjykim i 12 dhjetorit 2006, paragrafi 60; dhe, [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 61).
124. Rrjedhimisht, sipas GJEDNJ-së, një marginë apo hapësirë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih, rastin e GJEDNJ-së [Burden dhe Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 60; dhe rastin [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 76).
125. Gjykata në aplikimin e parimeve të përgjithshme, para së gjithash rikujton se Ligjvënësi në rast të kalimit nga skema kontributpaguese e moshës, në atë parciale, nëpërmjet nenit 8 të Ligjit të kontestuar, në mënyrë të parashikueshme ka paraparë mundësinë e kompensimit në formë tranzitore, në rast të reduktimit të lartësisë së pensionit. Respektivisht ky nen përcakton mënyrën e përlllogaritjes së lartësisë së pensionit parcial kontributpagues të moshës, sipas numrit të viteve të kontributeve të paguara, para 1 janarit 1999, e cila zbatohet pasi të jetë arritur kumulativisht periudha pesëmbëdhjetë (15) vjeçare e stazhit pensional, sipas kriterëve të përcaktuara përmes nënparagrafëve 2.2 dhe 2.3 të nenit 8A.
126. Gjykata vëren se kompensimi i diferencës së pensionit, në rast të kalimit nga skema e plotë, në skemën parciale kontributpaguese të moshës, parashihet si në vijim: (i) në vitin e parë, përkatësisht deri më 31 dhjetor 2023, pensionisti do të kompensohet me njëqind përqind (100%) të diferencës, ndërmjet pensionit të fundit të realizuar sipas Ligjit bazik, dhe pensionit që do të realizohet sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin e kontestuar; (ii) në vitin e dytë, përkatësisht deri më 31 dhjetor 2024, me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%); dhe (iii) në vitin tretë, përkatësisht deri më 31 dhjetor 2025, me pesëdhjetë për qind (50%). Ky kompensim tranzitor nuk do të aplikohet për personat që kanë filluar të marrin pension, pas 15 korrikut 2023, sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin e kontestuar.
127. Në këtë kontekst, formula për përcaktimin e lartësisë së pensionit parcial kontributpagues të moshës, merr për bazë: (i) lartësinë e pensionit bazik të moshës; (ii) koeficientin vjetor, sipas nivelit të arsimimit I, II, III, dhe IV; dhe (iii) numrin e viteve të kontributdhënies, para 1 janarit 1999.
128. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se dallimi i pensionit të një pensionisti, me përgatitje arsimore të nivelit III, që ka pesëmbëdhjetë (15) vite, pandërprerë kontributdhënie, me një pensionist që ka katërmëdhjetë (14) vite, kontributdhënie por që kumulativisht plotëson kriterin e kërkuar përmes nënparagrafit 2.4 të nenit 8A, është vetëm shtatë pikë gjashtëdhjetë (7.60) euro, ndërmjet skemës së plotë dhe asaj parciale kontributpaguese të moshës. Në këtë kuptim, (i) lartësia e pensionit sipas skemës parciale kontributpaguese të moshës (pasi të jetë përmbushur kumulativisht kushti i përcaktuar përmes nënparagrafit 2.4 të nenit 8A), do të jetë e përshkallëzuar sipas

viteve të kontributdhënies dhe do të aplikohet njëtrajtshëm për të gjithë punëtorët që janë larguar dhunshëm nga puna, përgjatë viteve 1989-1999.

129. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton se nëpërmjet Aktgjykimit [KO219/19](#), ndër të tjera, Gjykata kishte vënë theks në faktin që Qeveria, si propozuese e ligjeve dhe Kuvendi si ligjvënës që miraton ligjet, gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me rregullimin e sferave të ndryshme të interesit publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta, apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, duhet të kenë parasysh parimet e barazisë para ligjit dhe trajtimit e barabartë të të gjithë personave të drejtat e të cilëve preken nga çfarëdo lloj plotësimi ose ndryshimi ligjor, duke theksuar që Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurohen që vlerat kushtetuese për barazi para ligjit dhe mosdiskriminim të respektohen në gjithsecilën rrethanë dhe që çdo rregullim ligjor të jetë në përputhje me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës [KO219/19](#), cituar më lart, paragrafi 302).
130. Gjykata, bazuar në shtjellimet e mësipërme vlerëson se mënyra e përcaktimit të (i) kushteve dhe e (ii) lartësisë së pensioneve, përmes “skemës parciale kontributpaguese të moshës”, siç është rregulluar aktualisht përmes dispozitave të nenit 8A, të shtuara pas nenit 8 në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, është gjithëpërfshirëse, e cila njëtrajtshëm ua njeh (a) përvojën e punës dhe (b) kontributet pensionale, pa asnjë dallim të gjithë punëtorëve të dëbuar dhunshëm nga puna, përgjatë viteve 1989 - 1999, duke shmangur kështu çdo formë të diskriminimit dhe të trajtimit të pabarabartë para ligjit, mes grupeve të ndodhura në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike. Për më tepër, Gjykata thekson se edhe dallimi në trajtim i cili ekziston mes personave të ndodhur në situatë analoge apo relativisht të ngjashme, brenda vet grupeve, për sa i përket (i) kriterëve dhe (ii) lartësisë së pensioneve, është proporcional me qëllimin legjitim, ngase merr parasysh vitet e kontributdhënies, para 1 janarit 1999.
131. Thënë këtë, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, konstaton se skema parciale kontributpaguese e moshës, e shtuar në Ligjin bazik, nëpërmjet Ligjit të kontestuar është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur.
132. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se neni 4 i Ligjit të kontestuar, përmes të cilit shtohet neni 8/A, pas nenit 8 në Ligjin Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
133. Për sa i përket, pretendimit të parashtruesit të kërkesës, se neni 4 i Ligjit të kontestuar, që e shton nenin 8/A, pas nenit 8, në Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është në kundërshtim edhe me nenin 23 [Dinjteti i Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përveç faktit që thirret në shkelje të këtij neni, i njëjti nuk ka arsyetuar dhe argumentuar më tej, se si dhe pse dispozitat e shtuara në Ligjin bazik, nëpërmjet nenit 8A të Ligjit të kontestuar, janë në kundërshtim me nenin 23 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim duhet të deklarohet qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me nënregullin 2 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

IV. Përfundime

134. Si përmbledhje, duke pasur parasysh të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se ligjëvënësi me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit bazik, nëpërmjet nenit 4 të Ligjit të kontestuar, ka marrë parasysh gjetjet e Gjykatës, të shprehura përmes Aktgjyqimit të saj, në rastin KO190/19, të 30 dhjetorit 2022, ku specifikisht është kërkuar: (i) shmangia e normave diskriminuese nga Ligji bazik, që përjashtonin punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, administrative, gjyqësive, policisë, pozitave profesionale, të zanatit dhe të tjerëve, nga e drejta në pensionin kontributpagues të moshës, *vis a vis* kategorisë së punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, (ii) përfshirjen e punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, administratës, gjyqësorit, policisë, të zanatit dhe të tjerëve në skemën kontributpaguese të moshës, të cilët po ashtu u dëbuan nga puna, përgjatë viteve 1989-1999, duke rikujtuar faktin se: (iii) “...i takon pushtetit ekzekutiv dhe legjislativit,” që të përcaktojnë kriteret proporcionale dhe të arsyeshme, në lidhje me fitimin e statusit të pensionistit kontributpagues të moshës bazuar në kriteret proporcionale, sipas viteve të kontributeve.
135. Thënë këtë, Gjykata konstaton se neni 4 i Ligjit të kontestuar, që e shton nenin 8/A, pas nenit 8, në Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti nuk është në kundërshtim me dispozitat e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 113, dhe paragrafin 2 të nenit 116 të Kushtetutës, në nenet 20, 29 dhe 30 të Ligjit, dhe në bazë të rregullave 48 (1) (a), 65 dhe 72 të Rregullores së punës, më 20 maj 2025:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË njëzëri që neni 4 i Ligjit Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, që shton nenin 8A, pas nenit 8 në Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk është në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), si dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Safet Hoxha

Nexhmi Rexhepi